



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRI

URDHËR

Nr. 137, datë 14.10.2015

PËR

**MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË ORGANIKËS
SË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË AKREDITIMIT**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 7, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të nenit 10, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dhe të nenit 21, të ligjit nr.90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Struktura e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit të jetë sipas skemës 1, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Organika e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit të jetë sipas skemës 2, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Numri i punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit të jetë, gjithsej, 14 veta.
4. Urdhri nr.121, datë 16.10.2012, i Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit”, shfuqizohet.


Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

STRUKTURA E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË AKREDITIMIT

SKEMA



ORGANIKA E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË AKREDITIMIT

POZICIONI	KATEGORIA	NUMRI
I. DREJTOR I PËRGJITHSHËM		<u>1</u>
II. DREJTORIA E AKREDITIMIT		<u>(5)</u>
DREJTOR	III-a	1
SPECIALIST	IV-a	4
II. DREJTORIA E ZHVILLIMIT		<u>(5)</u>
DREJTOR	III-a	1
SPECIALIST	IV-a	2
SPECIALIST TI	IV-a	1
SPECIALIST	IV-b	1
III. SEKTORI I FINANCËS & SHËRBIMEVE		<u>(3)</u>
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a/1	1
SPECIALIST	IV-a	1
SPECIALIST	IV-b	1
PUNONJËS GJITHSEJ		14

KRYEMINISTRI

EDI RAMA